Universiteti "EPOKA" i jep prioritet të diplomuarve të tij, duke mbajtur lidhjet me ta edhe pas diplomimit të tyre. Falë mbështetjes që Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar u jep të diplomuarvë të Universitetit "EPOKA", është bërë e mundur një përqindje e lartë e të punësuarvë menjëhërë pas diplomimit. Nga të dhënat e mbledhura nga të diplomuarit e Universitetit "EPOKA" për vitin akademik 2016-2017, rezulton se 91.7 % e të diplomuarvë të këtij viti aktualisht kanë filluar punë në profesionin e tyre ose janë dukë ndjekur studimet e tyre Master. Ndërsa 49 të diplomuar të vitit akademik 2016-2017 aktualisht ndjekin studimet e tyre Master ose punojnë jashtë Shqipërisë.

Në tabelën e mëposhtme gjenden të dhënat e të diplomuarvë të vitit akademik 2016-2017 që ndodhen jashtë Shqipërisë:

Shteti	Austri	Belgjikë	Republika Çeke	Angli	Francë	Gjermani	Kosovë	Lihtheshtenij	Hollandë	Poloni	Katar	Spanjë	Suedi	Itali	Zvicër	Vietnam	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	Turqi	Gjithsej
Nr. i Studentëve	1	1	4	1	1	16	3	1	2	1	1	2	3	1	1	3	3	4	49

Gjatë vitit akademik 2016-2017, janë diplomuar 245 studentë në programet Bachelor dhe të integruara në Arkitekturë, Inxhinieri Ndërtimi, Inxhinieri Kompjuterike, Financë-Bankë, Financë-Bankë (Shqip), Informatikë Ekonomike, Ekonomiks, Administrim Biznesi, Marketing Ndërkombëtar dhe Logjistike, Inxhinieri Elektronike dhe Komunikim Dixhital si dhe Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. 71% e studentëve të diplomuar janë punësuar në institucione dhe kompani prestigjioze në Shqipëri dhe 20.7% e të diplomuarve të këtij viti vazhdojnë studimet master ose punojnë jashtë shqipërisë.

Fakulteti/ Emërtimi i progrmit të studimit	Nr. i të diplomuarve	Nr. i të punësuarve	Përqindja e të punësuarve
I. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë			
1. DIND- Arkitekturë	25	21	84%
2. BA- Inxhinieri Ndërtimi	22	20	90.9%
3. BA- Inxhinieri Kompjuterike	18	17	94.4%
4. BA- Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital	18	16	88.9%
II. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative			
1. BA- Financë-Bankë	45	40	88.9%
2. BA-Administrim Biznesi	12	9	75%
3. BA- Ekonomiks	20	19	95%
4. BA- Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare	14	11	78.5%
5. BA-Informatikë Ekonomike	31	29	93.5%
6. BA- Financë-Bankë (Shqip)	25	22	88%
7. BA-Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistike	15	13	86.6%

3. Përqindjen e suksesit në provimet e shtetit kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar, si edhe përqindjen e profesionistëve që kanë përfunduar këtë program studimi dhe janë licencuar.

Në përfundim të vitit akademik 2010-2011, studentët e parë janë diplomuar nga programi i studimit Bachelor (4-vjeçar) në Inxhinieri Ndërtimi, ndërkohë që studentët e parë janë diplomuar nga programi i studimit Bachelor (4-vjeçar) në Arkitekturë në fund të vitit akademik 2011-2012. Në këtë kuadër, periudha më e hershme që studentët në fjalë kanë pasur mundësi të përfundojnë një program studimi Master i Shkencave ose të barasvlefshëm që i jep mundësi për të hyrë në provimin e shtetit kanë qenë fundi i vitit akademik 2011-2012 për studentët e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe fundi i vitit akademik 2012-2013 për studentët e Arkitekturës. Lidhur me këtë çështje, institucioni nuk disponon informacion mbi numrin e të diplomuarve që kanë kaluar provimin e shtetit apo janë licencuar për vitin akademik 2016-2017.

4. RELACION NË LIDHJE ME PLOTËSIMIN E STANDARDEVE SHTETËRORE

A. PËRSHTATSHMËRIA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME MISIONIN E INSTITUCIONIT;

Siç është përmendur edhe më sipër, misioni i Universitetit “EPOKA” konsiston në të qenit një institucion mësimor-kërkimor inovativ dhe me ndikim, në shërbim të vlerave thelbësore njerëzore nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes dhe zhvillimit të dijeve në nivel ndërkombëtar; rritja e individëve me ndjeshmëri shoqërore, të mirëkualifikuar, produktivë, profesionalë dhe të përgjegjshëm, me qëllim të orientuar drejt kërkimit dhe të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare; si dhe dhënia e kontributit në kuadër të përmirësimit të cilësisë së jetës së shoqërisë bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale.

Fakultetet aktuale që ofrojnë programe studimi në Universitetin “EPOKA” janë:

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë:

- Departamenti i Arkitekturës;
- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
- Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike.

2. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative:

- Departamenti i Ekonomiksit;
- Departamenti i Financë-Bankës;
- Departamenti i Administrim Biznesit;

3. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative:

- Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;
- Departamenti i Drejtësisë;
- Qendra për Studime Europiane.

Në këtë kuadër, për përcaktimin e objektivave të të gjitha programeve të studimit, Fakultetet dhe Departamentet kanë si bazë misionin dhe vizionin e Universitetit. Të gjitha programet e studimit të të gjitha niveleve të ofruara nga ana e Universitetit synojnë të përgatisin njerëz të kualifikuar e të aftë që t’i shërbejnë sa më mirë shoqërisë dhe nevojave të saj, jo vetëm në planin kombëtar, por edhe në atë global. Me qëllim mundësimin e integritimit sa më të lehtë të të diplomuarve në tregun e punës, një rëndësi e veçantë i është kushtuar lëndëve aplikative si dhe praktikave të punës, qoftë si pjesë e aktiviteteve kurrikulare, ashtu edhe atyre jashtëkurrikulare.

B. REALIZIMI I SYNIMEVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT NGA ANA PËRMBAJTËSORE

Programet e studimit të Universitetit “EPOKA” janë në përputhje me misionin dhe vizionin e Universitetit. Një nga synimet kryesore të përbashkëta të programeve është përgatitja e intelektualëve të rinj, me dije të mjaftueshme dhe të gatshëm për të kontribuar në përballimin e nevojave të shoqërisë si dhe të aftë në menaxhimin e ekonomisë së vendit, nëpërmjet një kurrikule bashkëkohore dhe në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

Fakti që mësimdhënia në shumicën e programeve zhvillohet në gjuhën angleze si gjuha e vetme e procesit të mësimdhënies, ofron mundësinë e përdorimit të literaturës më të përditësuar dhe më të njohur në fushat përkatëse të studimit, si dhe siguron akses shumë të lehtë të studentëve në burimet elektronike dhe të shtypura të informacionit.

Me qëllim që studentët të dalin të mirëpërgatitur dhe të jenë të aftë të përfaqësojnë denjësisht veten dhe Universitetin “EPOKA”, duhet që patjetër të kenë përvetësuar programin mësimor duke u diplomuar vetëm nëse kalojnë në të gjitha lëndët dhe sigurojnë një mesatare të përgjithshme 2.00 nga 4.00, e cila me pikë i korrespondon 70-74, ndërsa sipas sistemit shqiptar, notës 7.

C. REALIZIMI I SYNIMEVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT NËPËRMJET MBULIMIT ME PERSONELIN AKADEMIK TË PËRSHTATSHËM;

Universiteti “EPOKA” ka siguruar një staf të mirëkualifikuar për një mësimdhënie cilësore në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare. Kështu, në semestrin e vjeshtës 2017-2018 janë angazhuar në procesin mësimdhënës në Universitet 91 pedagogë, prej të cilëve 4 me titullin “Profesor Doktor”, 11 me titullin “Profesor i Asocuar”, 35 me titullin “Asistent Profesor Doktor” dhe 41 me titullin “Master”. Ndërsa në semestrin e pranverës 2017-2018 janë angazhuar në procesin mësimdhënës në Universitet 109 pedagogë, prej të cilëve 6 me titullin “Profesor Doktor”, 15 me titullin “Profesor i Asocuar”, 41 me titullin “Asistent Profesor Doktor” dhe 47 me titullin “Master”. Në semestrin e vjeshtës 2017-2018, 60,55 % e stafit akademik ishte i punësuar me kohë të plotë, ndërkohë që për semestrin e pranverës 2017-2018, 66 % e stafit akademik ishte i punësuar me kohë të plotë.

Fakti që anglishtja është gjuha zyrtare e mësimdhënies në institucion, ajo lehtëson edhe thithjen e stafit të huaj akademik, me tituj dhe grada shkencore, i mirëkualifikuar dhe me përvojë për mësimdhënie sipas kurrikulave bashkëkohore të Universitetit “EPOKA”.

D. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM MBI CILËSINË E STUDENTËVE DHE VLERËSIMI I TYRE PËR SECILIN VIT STUDIMI.

MESATARET E STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË NE BAZË VITI DHE PROGRAMI STUDIMI					
Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit	VITI I PARË	VITI I DYTË	VITI TRETË₄	VITI KATËRT	VITI PESTË
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE INXHINIERISË	2.04	2.41	2.16	2.34	2.42
INXHINIERI NDËRTIMI	1.81	2.9	2.03	-	-
INXHINIERI KOMPJUTERIKE	2.05	1.88	1.96	-	-
ARKITEKTURË	-	-	-	-	-
DIND-ARKITEKTURË	2.24	2.68	2.65	2.34	2.42
INXHINIERI ELEKTRONIKE DHE KOMUNIKIMI DIXHITAL	2.07	2.16	2.0	-	-
FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE ADMINISTRATIVE	2.2	2.57	2.28	-	-
FINANCË-BANKË	2.48	2.85	2.57	-	-
FINANCË-BANKË (SHQIP)	2.17	2.72	2.3	-	-
ADMINISTRIM BIZNESI	1.98	2.09	1.72	-	-
EKONOMIKS	2.46	2.82	2.62	-	-
INFORMATIKË EKONOMIKE	2.19	2.49	2.35	-	-
MARKETING NDERKOMBETAR DHE MENAXHIM LOGJISTIKE	1.97	2.39	2.25	-	-
FAKULTETI I DREJTESISË DHE SHKENCAVE SOCIALE	2.47	2.89	1.88	-	-
SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE	2.47	2.89	1.88	-	-
MESATARJA E PËRGJITHSHME	2.23	2.62	2.11	2.34	2.42

MESATARET E STUDENTËVE TË CIKLIT TE DYTË DHE TË TRETË NË BAZË PROGRAMI STUDIMI			
Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit	CIKLI I DYTË		CIKLI I TRETË
	PM	MSC	PhD
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE INXHINIERISË	2.46	3.14	3.82
INXHINIERI KOMPJUTERIKE	2.31	2.86	3.84
INXHINIERI NDËRTIMI	2.62	3.2	3.38
ARKITEKTURË	-	3.37	3.81
INXHINIERI ELEKTRONIKE DHE KOMUNIKIMI DIXHITAL	-	3.16	-
FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE ADMINISTRATIVE	2.04	3.25	3.79
FINANCË- BANKË	2.34	3.19	3.92

⁴ Në vitin e tretë është i paraqitur sistemi 3-vjeçar si edhe sistemi 4-vjeçar, ku përfshihen edhe studentët e prapambetur.

ADMINISTRIM BIZNESI	1.75	3.15	3.51
EKONOMIKS	-	3.42	3.93
MENAXHIM BIZNESI: PROFILI MENAXHIM ARSIMI	-	-	-
FAKULTETI I DREJTËSISË DHE SHKENCAVE SOCIALE	3.28	3.09	3.57
SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE	3.28	3.09	3.57
MESATARJA E PËRGJITHSHME	2.59	3.16	3.73

E. RAPORTIM I PËRGJITHSHËM TABULAR I TË DHËNAVE TË VLERËSIMIT TË STUDENTËVE NDAJ PERSONELIT AKADEMIK.

Në përfundim të çdo semestri, të gjithë pedagogët e Universitetit “EPOKA” i nënshtrohen vlerësimit nga ana e studentëve. Pyetësi përmban 14 pyetje për të cilat studentët shprehen me një interval vlerësimi nga 0 që do të thotë “nuk pajtohem”, deri në 4 që do të thotë “pajtohem plotësisht”.

Në fund të çdo semestri përkatës të vitit akademik 2017-2018, vlerësimi mesatar për të gjithë pedagogët për secilën pyetje ishte si më poshtë:

Nr	Pyetja	Vlerësimi mesatar për semestrin I	Vlerësimi mesatar për semestrin II
1	Përmbledhja dhe objektivat e lëndës ishin paraqitur qartë në syllabus	3.41	3.46
2	Libri dhe/ose materialet e tjera të leximit të ndihmonin për të kuptuar temën	3.35	3.42
3	Lënda rriti dijet dhe interesin tim mbi temën	3.35	3.41
4	Metodat e mësimdhënies në këtë lëndë ishin të përshtatshme	3.33	3.4
5	Pedagogu ishte përgatitur mirë për leksionet	3.42	3.47
6	Pedagogu tregoi vëmendje për ecurinë time	3.28	3.38
7	Pedagogu ishte i disponueshëm për të ndihmuar jashtë auditorit	3.35	3.44
8	Pedagogu vinte në kohë në auditor	3.5	3.5
9	Pedagogu vinte rregullisht në leksione	3.5	3.51
10	Pedagogu përdori në mënyrë të përshtatshme materialet e lëndës në lidhje me temat	3.37	3.45
11	Pedagogu e përdori gjuhën e mësimdhënies në mënyrë të efektshme	3.39	3.46
12	Pedagogu e vlerësoi punën time në mënyrë të drejtë	3.36	3.44
13	Pedagogu pati dialog efektiv me studentët gjatë leksioneve	3.38	3.44
14	Pedagogu e përfshiu dhe motivoi klasën shumë mirë	3.32	3.4

F. RELEVANCA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME ZHVILLIMET E FUNDIT EKONOMIKE NË VEND DHE ME TREGUN E PUNËS, OSE ME ZHVILLIMET E FUNDIT KULTURORE NË FUSHAT E ARTIT.

Programet e studimit që ofrohen në Universitetin “EPOKA” janë në përputhje me zhvillimet e fundit ekonomike në vend dhe me tregun e punës në fushat respektive. Programet e ofruara për studentët janë ofruar që në fillimet e veta nëpërmjet një analize tregu të realizuar nga instancat përgjegjëse të institucionit.

Universiteti “EPOKA” është angazhuar të japë kontribut në fusha të ndryshme si në ekonomi, financë, teknologji informacioni, arkitekturë, inxhinieri ndërtimi etj. Objektivat e programeve reflektohen mjaft mirë në rezultatet e arritura dhe punët konkrete të studentëve.

Ofrimi i infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin normal të procesit arsimor, ka qënë dhe do të jetë gjithmonë në relevancë të plotë me zhvillimin e teknologjisë. Në këto kushte, me modernizimin e kurrikulave, cilësinë e lartë të shërbimit dhe përkujdesjen me anë të programeve këshilluese për studentët tanë, mendojmë që ata janë të aftë të përshtaten mjaft mirë me kushtet e tregut të punës, dhe emri i tyre të përfaqësojë mjaft mirë institucionin që janë diplomuar.

INFORMACION MBI SHËRBIMIN NDAJ KOMUNITETIT OSE NDËRVEPRIMIN E INSTITUCIONIT ME PUBLIKUN

Një nga tre elementet kryesore në kuadër të të cilave Universiteti “EPOKA” operon, është edhe kontributi ndaj shoqërisë.

Në kuadër të planifikimit të karrierës dhe bashkëpunimit që ka me Drejtorite Arsimore, Universiteti “EPOKA” ka ftuar grupe të ndryshme maturanësh në mjediset e saj për të informuar më me detaje maturanët në lidhje me profesione të ndryshme në prag të diplomimit të tyre. Në të njëjtën kohë u ka dhënë mundësinë maturanëve të testonin nivelin e tyre në gjuhën Angleze duke qënë se edhe këtë vit provimi i gjuhës Angleze ka qënë i detyrueshëm.

Gjithashtu në kuadër të një planifikimi karriere më të mirë ka bërë të mundur takimin e tyre me pedagogë të ndryshëm për marrjen e një informacioni më të detajuar për çdo program që universiteti ynë ofron. Në këto seminare kanë marrë pjesë mbi 3100 maturanë nga 17 rrethe të Shqipërisë. I njëjti program informimi është aplikuar edhe me trojet shqiptare. Këtë vit Universiteti “EPOKA” ka qënë pjesë e një sërë panairesh të organizuara nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë në qytete të ndryshme ku si qëllim ka patur një informim sa më të mirë për të gjithë maturanët në vendin tonë.

Duke patur prioritet rregjistrimin e studentëve me rezultate të larta, Universiteti “EPOKA” vlerëson meritat e secilit prej studentëve përmes bursave si mëposhtë:

Bursa për studentët më të mirë të Maturës Shtetërore

- 6600 pikë apo më shumë » 100% bursë
- 6400 – 6599.99 pikë » 75% bursë

- o 6200 – 6399.99 pikë » 50% bursë

Bursat bazuar në rezultatet e Provimit SAT

- o 1300 pikë apo më shumë » 100% bursë
- o 1290 - 1349 pikë » 75% bursë
- o 1220 - 1289 pikë » 50% bursë

Për vitin e ri akademik universiteti ka vendosur dhënien e bursave të plota për disa kategori të ndryshme. Vlen të përmenden bursat që do të jepen për fëmijët e ish-policëve të rënë në krye të detyrës, fëmijeve jetimë, fëmijëve nga komuniteti Romë dhe Egjiptian si dhe gjithashtu sportistëve të dalluar. Edhe për programet Master, Doktoratë dhe për studentët e transferuar do të ketë disa kategori bursash ku kriter do të jetë mesatarja e studimeve.

Në të njëjtën kohë, si çdo vit tjetër, janë shpërndarë bursa për më të mirët e konkurseve dhe workshop-eve të organizuara nga departamente të ndryshme të Universitetit “EPOKA” si Brain Ring, IDCHSS, Leading the Future Workshop etj.

Klubet Studentore

Klubet studentore të Universitetit “EPOKA”, në përputhje me Rregulloren “Mbi klubet studentore”, si dhe falë mjedisit të universitetit, synojnë zhvillimin e studentëve jo vetëm në aspektin akademik, por edhe atë social, kulturor, intelektual dhe sportiv, si një faktor i rëndësishëm i bashkëjetesës dhe një nxitje në promovimin e vlerave humane tek të rinjtë.

Këto klube janë ngritur dhe drejtohen nga studentët e universitetit nën mbikqyrjen e një këshilluesi që mund të jetë pjesë e stafit akademik ose administrativ. Gjatë aktiviteteve të klubit, secili student zbulon te vetja cilësitë e tij dominante që e bëjnë të ndryshëm nga të tjerët, i kushtohet shumë rëndësi bashkëpunimit, aftësive menaxhuese dhe komunikimit, duke ofruar kështu një mundësi praktike për të përfutuar aftësi që nuk mund të merren në orë teorike dhe duke formuar një produkt të plotësuar të gatshëm për tregun e punës.

Në Universitetin “EPOKA” zhvillojnë veprimtarinë e tyre një numër i madh i klubeve studentore që plotësojnë interesin e të gjithë studentëve të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emri i Klubit
1	Klubi i Akademikëve
2	Klubi i Artit dhe Kulturës
3	Klubi i Inxhinierëve të Ardhshëm
4	Klubi i Financës
5	Klubi i Lidërsipit të Grave
6	Klubi i Programimit
7	Klubi i Shoqërisë Sensitive (Sensitive Society)

8	Klubi i Inovatorëve
9	Klubi Marketing Zone
10	Klubi Sporteve
11	Klubi për Zgjidhjen e Konfliktëve
12	Klubi Rrjeti i Ekonomistëve të Rinj

Gjatë vitit akademik 2017 – 2018, klubet studentore kanë ndërmarrë një sërë aktivitete në shërbim të komunitetit të paraqitura si më poshtë:

1. Klubi studentor “Sensitive Society” në bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare të Jetimëve me 4 qershor 2018 ftuan në ambjentet e Universitetit “EPOKA” disa fëmijë jetim për të festuar ditën e fëmijëve, 1 qershorin. U organizuan disa aktivitete me muzikë dhe lojëra për ti zbavitur ato. Gjithashtu studentët e Epokës dhuruan lodra, rroba dhe ndihma monetare për fëmijët. Lodrat dhe rrobat u dhuruan të paketuara tek fëmijët ndërsa me paratë e mbledhura u përgatitën pako me ushqime.
2. Çdo vit në ambjentet e Universitetit “EPOKA”, Dekanati i Studentëve, organizon “Spring Fest” që u jep mundësinë studentëve të shijojnë një ditë të veçantë me shumë aktivitete. Në këtë festë ka gjithmonë këngëtarë e artistë të ndryshëm. Këtë vit bashkëpunuam me klubin studentor “Sensitive Society” për një kauzë të rëndësishme. Kjo festë u bë me “bileta” dhe paratë e mbledhura iu dhuruan një vajze 4-vjeçare e diagnostikuar me tumor. Në këtë ditë u bënë edhe kompeticione talentesh mes studentëve, tatuazhe me këna dhe kurora me lule të organizuara nga klubi i Artit dhe Kulturës. Ishin të ftuar shumë këngëtarë të cilët krijuan një atmosferë me shumë ngjyra.
3. Më 20 mars 2018 u ndërmor fushata e mbjelljes së pemëve. Stafi dhe studentët e Universitetit Epoka u bënë pjesë e kësaj fushate duke blerë pemë për ti mbjellur ato në ambjentet e kampusit të universitetit. Paratë që u përfituan nga shitja e pemëve, u blenë ushqime dhe u dërguan tek familjet e varfra të zonës së Paskuqanit.
4. Në kuadër të festave të fundvitit klubi studentor Sensitive Society iu bashkua në ndihmë fëmijëve të fshatis SOS. Fëmijët kishin përgatitur disa kartolina për Vitin e Ri dhe Krishtlindjet ndërsa studentët kontribuan në shitjen e tyre. Paratë e mbledhura nga këto kartolina iu dhuruan fshatit SOS.
5. Përgjatë gjithë muajit prill 2018, studentët e klubit Sensitive Society organizuan fushatën e mbledhjes së librave. Librat që u mbledhën në këtë fushatë u dërguan në luginën e Preshevës.
6. Në datat 9 dhe 11 maj 2018, stafi dhe studentët e Universitetit “EPOKA” u bënë pjesë e fushatës së dhurimit të gjakut. Në total patën mundësi të dhuronin 56 persona, të cilët ishin të përshtatshëm për dhurim.

7. Epoka League (Kampionati Ndërkombëtar i Futbollit për shkollat e mesme) është një turne minifutbolli mes shkollave të mesme. Ky turne u zhvillua në ambientet e Universitetit Epoka. Në këtë turne morën pjesë nxënës të shkollave të mesme të shteteve të ndryshme, si Shqipëria, Kosova, Bosnjë-Hercegovina dhe Maqedonia. Ekipet për çdo shkollë të mesme përbëheshin nga 10 nxënës (lojtarë) dhe 2 përfaqësues të stafit të shkollës përkatëse. Nxënësit pjesëmarrës duhet të jenë maksimalisht të datëlindjes 01 qershor 1998. Në total morën pjesë 240 nxënës.
8. Këshilli Rinor i Shteteve të Bashkuara në bashkëpunim me klubin studentor Conflict Resolution organizuan në datat 13 dhe 14 janar 2018, trajnimin me temë “No Hate Speech” e cila u organizua në ambientet e Universitetit “EPOKA”. Fokusi i këtij trajnimi ishin 20 të rinj nga shkolla e mesme e Kamzës.
9. Klubi studentor Marketing Zone edhe këtë vit organizoi Brain Ring. Ky aktivitet është një garë midis nxënësve të shkollave të mesme. Çdo shkollë e mesme përbëhet nga një skuadër me 5 nxënës. Vendin e parë këtë vit e fitoi kolegji “Turgut Ozal”. Grupi fitues përfitoi një bursë prej 20% në Departamentin e Biznesit si edhe 7000 lek për person.
10. Klubi studentor i Financës organizoi një trajnim në lidhje me programin e Financës 5. Financa 5 është një program financiar për bizneset e vogla, të mesme dhe të mëdha. Instruktores e trajnimit ishte Zj. Albana Demi. Ky trajnim u mbajt një herë në javë dhe zgjati 5 javë. Trajnimi ishte i hapur për studentë të Epokës dhe studentë të universiteteve të tjera. Në fund të trajnimit pjesëmarrësit u pajisën me çertifikata.
11. Më 21 mars 2018 Klubi i Inovatorëve në bashkëpunim me komunitetin Blockchain të Ballkanit Perëndimor sollë workshopin e Blockchain Western Balkans. Z. Klajdi Turlla ishte përfaqësues i komunitetit dhe foli për Bitcoin dhe Blockchain. Prezantimi i tij përbëhej nga tri pjesë kryesore:
 - 1- Hyrje në Bitcoin
 - 2- Nga Bitcoin drejt Blockchain
 - 3- Aktualiteti
 Funksionimi i këtyre monedhave të shpërndara bazohet në një protokoll të njohur si Blockchain. Blockchain regjistron të dhënat për transaksionet digjitale. Meqenëse kjo teknologji është shumë e sigurt dhe e pavarur, ajo "përqafohet" nga vendet shumë të zhvilluara.
12. Klubi studentor i Inovatorëve në bashkëpunim me Dija Center organizuan një trajnim tre ditor në datat 5, 6 dhe 7 prill 2018 në ambientet e Universitetit “EPOKA” në lidhje me akademinë e start up-it. Udhëheqësi i trajnimit ishte z. Erjon Nako.

Gjatë vitit akademik 2017-2018, në Universitetin “EPOKA” janë zhvilluar Forumet e Hapura si më poshtë:

Forumet e Hapura, Viti Akademik 2017-2018			
Nr	I Ftuar	Tema	Data
1.	Ervin Kalemi	Çelësi i Suksesit 5.0	08.11.2017
2.	Josif Gjani	Mundësitë e Zhvillimit të Karrierës tek Abkons	08.11.2017
3.	Jolanda Ymeri	Marketingu Dixhital	14.11.2017
4.	Majlinda Bregu	Të njohësh Europën dhe Bashkimin European	19.12.2017
5.	Gledis Gjipali	Zgjerimi i BE dhe Integrimi: Mundësitë dhe Sfidat	15.01.2018
6.	Spiro Brumbulli	Sistemi Bankar në Shqipëri	18.01.2018
7.	Ina Xhepi	Instrumentet e BE për Zhvillim të Demokracisë dhe Mbrojtjen e të Drejtave Humane	23.01.2018
8.	Çlirim Gjata	Sfidat e Politikës në Shqipëri: Reforma në Drejtësi	24.01.2018
9.	Mimoza Kalia	Taksa Administrative, Proçedura e Apelimit	30.01.2018
10.	Klodian Allajbeu; Erion Nako; Adion Gorani; Ermal Jauri; Kastriot Luma; Almin Shaqiri.	LEAP Summit Albania: Fjalime Motivuese Bazuar në Eksperienca Personale	31.01.2018
11.	Mimoza Hafizi	Flas për Barazinë Gjinore	06.03.2018
12.	Anjeza Bojaxhiu; Lindita Lushaku; Marsela Allmuça.	Nuk Ishte Fati Im	07.03.2018
13.	Olta Manjani	Sistemi Monetar: Roli i Bankës Qëndrore në Shqipëri	13.03.2018
14.	Ariel Ahart; Ardiana Jaku; Eliona Demaliaj; Gerta Hagen.	Dhuna në Bazë Gjinore	13.03.2018
15.	Turjan Hyska	Çelësi i Suksesit 6.0	28.03.2018
16.	Paola Topali	Shëndeti dhe Siguria gjatë punës në Ndërtim	04.04.2018
17.	Erjon Skënderi	Politikat Sociale të disa Institucioneve në Shqipëri në Dekadën e Fundit	04.05.2018
18.	Lorik Cana	Karriera e tij në Futboll	18.05.2018
19.	Judge J. Stephen Czuleger	Besimi i Publikut dhe Përgjegjësia	23.05.2018
20.	Kei Hysi Kelvin Cobanaj Klajdi Ballanca Teadora Suku Shejlida Domnori Ditjona Lila Tuqa Rahman Bleona Duka Franceska Picari Gestjan Mekshi	EpokaTalks	24.05.2018
21.	Petrit Çela	Të Studiosh Jashtë	30.05.2018

Panairi i Karrierës

Panairi i Karrierës u organizua për të pestin vit radhazi në Universitetin “EPOKA”. Në këtë event morën pjesë 60 kompani të mirënjohura të cilat operojnë në tregun vendas, të cilat i dhanë mundësi 302 studentëve të universitetit të intervistoheshin për vende vakante pune si edhe intervista për programet e internshipit.

Panairi i Karrierës kishte rezultate të menjëherëshme ku si rezultat i tij një pjesë e madhe e studentëve përfituan praktika profesionale 1-2 mujore pranë kompanive në bazë të profilit të tyre ndërsa 11 studentë u përzgjedhën për të filluar punë menjëherë pasi të diplomohen. Numri i personave të cilat fituan kontratën e punës nga ky event u rrit në ditët në vijim pasi kaluan fazat e intervistimit.

Më poshtë do të gjeni listën e kompanive pjesëmarrëse në panair.

Nr.	Kompania	Nr.	Kompania	Nr.	Kompania
1	Abissnet	21	Sicred	41	AISEEC
2	Telekom Albania	22	Shero Design	42	Agna Group
3	Credins Bank	23	Alba Punesim	43	Jon Shpk
4	Deloitte Albania & Kosova	24	Societe Generale Albania	44	Boiken Developments
5	Dua Pune	25	P&P	45	Forward shpk
6	Gener 2	26	Armundia Factory	46	Balfin Group
7	Intesa Sanpaolo Bank	27	Unique junior Enterprises	47	Univer Reklama
8	Kontakt Shpk	28	Century 21 Prestige	48	AMD
9	Kpmg	29	Marketing & Distribution	49	Eppc Albania
10	ProCredit Bank	30	GIZ/ DIMAK	50	Colliers Internationals
11	Vodafone	31	Alba Consulting	51	Modern Engineering
12	Aluflor Construction Group	32	Balkan Sport	52	Web Host
13	Dominusoft	33	Raiffeisen Bank	53	TOK/Digital Agency
14	Europe Agency	34	Agjensia Erca	54	Megatek
15	Njoftime.com	35	Pwc Albania	55	Ikons
16	Noa	36	Local Web	56	Forcontact
17	Metropolitan Inkubator	37	Eurosig	57	Smartwork
18	Allan lloyds	38	Soft Mogul	58	Andaras Studio
19	Tirana Business park	39	Insig	59	Realtech
20	British American Tobacco	40	Ernst & Young	60	Communication Progres

G. INFORMACION NË FORMË TABELARE MBI BASHKËPUNIMET NDËRINSTITUCIONALE DHE PROJEKTET KU MERR PJESË INSTITUCIONI, KU PARAQITEN TË DHËNA MBI INSTITUCIONIN BASHKËPUNUES/PROJEKTIN (ADRESË, EMËR), DATËN DHE FORMËN E FORMALIZIMIT TË BASHKËPUNIMIT/PROJEKTIT (KONTRATË, MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ETJ.), SEKTORIN E BASHKËPUNIMIT (MËSIMDHËNIE, KËRKIM SHKENCOR, ETJ.), DETYRAT E PALËVE DHE PRODUKTET, REZULTATET APO PËRFITIMET QË PRITEN NGA KY BASHKËPUNIM.

Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes Universitetit “EPOKA” dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor është si më poshtë:

Nr.	Universiteti	Shteti	Hyrja në fuqi	Përfundim i i afatit	Forma e bashkëpunimit	Fusha e bashkëpunimit
1.	Universiteti i Kalifornisë në Pensilvani	SHBA	12.06.2015	12.06.2020	Memorandum Bashkëpunimi	-Bashkëpunim në programet e doktoratës -Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
2.	Universiteti Amerikan i Bullgarisë	Bullgari	02.02.2013	Pa afat	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
3.	Universiteti Amerikan në Emiratet e Bashkuara Arabe	E.B.A	27.07.2009	Pa afat	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
4.	Universiteti Nicolaus Copernikus	Poloni	12.05.2015	12.05.2018	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
5.	Universiteti Shtetëror Baku	Azerbajxhan	31.10.2011	31.10.2021	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
6.	Universiteti Hëna e Plotë (Bedër)	Shqipëri	06.12.2012	06.12.2017	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
7.	Universiteti Ndërkombëtar Ataturk Alattoo	Kirgizistan	29.09.2009	29.09.2019	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
8.	Universiteti Ndërkombëtar i Ballkanit	Maqedonia	22.10.2009	Pa afat	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore

9.	Universiteti Ndërkombëtar i Detit të Zi	Gjeorgji	09.09.2009	09.09.2019	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
10.	Universiteti Ndërkombëtar Burch	Bosnje-Hercegovinë	23.05.2013	23.05.2023	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
11.	Universiteti Ishik	Irak	29.10.2013	29.10.2017	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
12.	Universiteti Kubolashak	Kazakistan	09.09.2009	-	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
13.	Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”	Shqipëri	-	-	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
14.	Universiteti Qafqaz	Azerbajxhan	13.09.2009	13.09.2019	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
15.	Universiteti Shtetëror “Sam Houston”	SHBA	24.08.2009	24.08.2020	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
16.	Universiteti i Europës Juglindore Lumina	Rumani	21.10.2011	21.10.2021	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
17.	Universiteti i Texasit në Austin (Texas Pavement Preservation Center)	SHBA	06.05.2009	15.11.2018	Memorandum Bashkëpunimi	Bashkëpunim në kuadrin e qendrave kërkimore, Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
18.	Universiteti Politeknik i Barit	Itali	12.11.2009	12.11.2019	Memorandum Bashkëpunimi	Bashkëpunim mbi bazë Fakulteti -Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
19.	Universiteti i Shkencave të Aplikuara	Gjermani	10.05.2012	Rinovoht automatikisht çdo katër vite	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
20.	Universiteti i Teknologjisë	Zvicër	29.10.2013	29.10.2017	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
21.	Universiteti i Tiranës	Shqipëri	14.02.2014	14.02.2019	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh

						shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
22.	Shkolla e Biznesit EADA	Spanjë	31.11.2014	31.11.2017	Memorandum Bashkepunimi	Bashkëpunim mbi bazë Fakulteti Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
23.	Universiteti i Teknologjisë në Tallinn	Estoni	20.10.2014	20.10.2017	Memorandum Bashkepunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
24.	Universiteti Zaman	Kamboxhia	05.03.2015	05.03.2020	Memorandum Bashkepunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
25.	Universiteti i Salernos	Itali	07.08.2015	06.08.2018	Memorandum Bashkepunimi	Bashkëpunim mbi bazë Fakulteti Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
26.	Universiteti i Cassino dhe Lazio Jugore	Itali	15.09.2015	14.09.2020	Memorandum Bashkepunimi	Bashkëpunim mbi bazë Fakulteti Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
27.	Universiteti Sapienza i Romës	Itali	14.09.2015	13.09.2018	Memorandum Bashkepunimi	Bashkëpunim mbi bazë Fakulteti Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
28.	Kolegji Riinvest	Kosovë	08.02.2016	07.02.2019	Memorandum Bashkepunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore

Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes Universitetit “EPOKA” dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në kuadrin e programit “Erasmus +” është si më poshtë:

Nr.	Institucioni	Shteti	Statusi	Vlefshmëria
1.	Universiteti Teknik Geroghe Asachi" Din Iasi	Rumani	Aplikuar/ Aprovuar	2016-2021
2.	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz	Gjermani	Aplikuar/ Aprovuar	2017-2018
3.	Universiteti Politeknik i Barit	Itali	Aplikuar/ Aprovuar	2016-2017
4.	Universiteti i Salernos	Itali	Aplikuar/ Aprovuar	2017-2021

5.	Universiteti i Teknologjisë i Gdansk	Poloni	Aplikuar/ Aprovuar	2017-2018
6.	Universiteti Ndërkombëtar i Logjistikës dhe Transportit	Poloni	Aplikuar/ Aprovuar	2017-2018

Programet e shkëmbimit të studentëve

Gjatë vitit akademik 2017-2018, studentët kanë përfituar një ose dy semestra nga programet e shkëmbimit në kuadër të zbatimit të marrëveshjeve dypalëshe dhe marrëveshjeve të Programit Erasmus+.

Nr	Emër	Mbiemër	Departamenti	Uni. Pritës	Shteti	Viti Akademik	Semestri	Metoda
1.	Bora	Kokalari	MSc në Financë Bankë	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz	Gjermani	2017-2018	I-II	Erasmus+
2.	Emanuela	Buci	MSc në Financë Bankë	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz	Gjermani	2017-2018	I-II	Erasmus+
3.	Vilma	Dhuli	MSc në Financë Bankë	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz	Gjermani	2017-2018	I-II	Erasmus+
4.	Kira	Cami	Administrim Biznesi	Universiteti i Kalifornisë në Pensilvani	SHBA	2017-2018	I	Marrëveshje Dypalëshe
5.	Alkeo	Taga	Administrim Biznesi	Universiteti Ndërkombëtar i Logjistikës dhe Transportit	Poloni	2017-2018	I	Erasmus+
6.	Inesa	Verleni	Ekonomiks	Universiteti i Salernos	Itali	2017-2018	II	Erasmus+
7.	Melisa	Pajo	Ekonomiks	Universiteti i Salernos	Itali	2017-2018	II	Erasmus+
8.	Amela	Dervishi	Ekonomiks	Universiteti i Salernos	Itali	2017-2018	II	Erasmus+
9.	Denis	Mehillaj	Administrim Biznesi	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz	Gjermani	2017-2018	II	Erasmus+
10.	Eris	Dervishi	Arkitekturë	Universiteti i Teknologjisë i Gdansk	Poloni	2017-2018	II	Erasmus+
11.	Joana	Doko	Administrim Biznesi	Universiteti Ndërkombëtar i Logjistikës dhe Transportit	Poloni	2017-2018	II	Erasmus+

Në bazë të marrëveshjeve në fuqi, gjatë vitit 2017-2018, Universiteti “EPOKA” priti studentët si më poshtë:

Nr.	Emer	Mbiemer	Universiteti	Programi	Semestri
1.	Shakhlo	Shermukhamedova	Universiteti Ndërkombëtar i Logjistikës dhe Transportit	BA IML	Vjeshtë
2.	Askarjon	Khidirov	Universiteti Ndërkombëtar i Logjistikës dhe Transportit	BA IML	Vjeshtë
3.	Stefania	Cappa	Universiteti Politeknik I Barit	ARCH	Pranverë
4.	Francesca	Diaferia	Universiteti Politeknik I Barit	ARCH	Pranverë
5.	Antonella	Losito	Universiteti Politeknik I Barit	ARCH	Pranverë
6.	Donatella	Lanzilotti	Universiteti Politeknik I Barit	ARCH	Pranverë
7.	Andrea	Bogotto	Universiteti Politeknik I Barit	ARCH	Pranverë
8.	Riccardo	Catamo	Universiteti Politeknik I Barit	ARCH	Pranverë
9.	Gabriele	Ajo	Universiteti Politeknik I Barit	ARCH	Pranverë
10.	Adenisa	Mirdita	Universiteti i Salernos	ECO	Pranverë

Programi i shkëmbimit “Erasmus +”

Erasmus + është një program arsimor i Bashkimit Evropian që synon modernizimin e sistemeve arsimore dhe përshtatjen e tyre me nevojat e tregut të punës. Erasmus + bashkon shtatë programet arsimore të BE-së duke lehtësuar orientimin e përfituesve dhe rregullat e pjesëmarrjes.

Në bazë të marrëveshjeve në fuqi, gjatë vitit 2017-2018 Universiteti “EPOKA” priti stafin akademik si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër	Titulli Akademik	Universiteti Dërgues	Departamenti	Metoda	Periudha e shkëmbimit
1.	Maria Fedele	MSc.	Universiteti i Cassino dhe Lazio Jugore	Administrim Biznesi	Marrëveshje Dypalëshe	11.12.2017-12.12.2017
2.	Piotr Lorens	Prof. Dr.	Universiteti i Teknologjisë i Gdansk	Arkitekturë	ERASMUS+	19.02.2018-23.02.2018
3.	Michal Habier	Mr.	Universiteti i Teknologjisë i Gdansk	Arkitekturë	ERASMUS+	29.01.2018-02.02.2018
4.	Wollny Volrad	Prof. Dr.	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz	Administrim Biznesi	ERASMUS+	05.03.2018- 09.03.2018
5.	Karsten Lorenz	Prof. Dr.	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz	Administrim Biznesi	ERASMUS+	26.05.2018 - 31.05.2018
6.	Senol Dogan	Dr.	Universiteti Ndërkombëtar i Burch	Inxhinieri Kompjuterike	Marrëveshje Dypalëshe	15.05.2018 - 15.08.2018
7.	Ceylani Akay	Assist. Prof. Dr.	Universiteti Ndërkombëtar i Burch	Ekonomiks	Marrëveshje Dypalëshe	01.05.2018 - 30.07.2018
8.	Muhammet Sait Dinc	Assoc. Prof. Dr.	Universiteti Ndërkombëtar i Burch	Administrim Biznesi	Marrëveshje Dypalëshe	02.05.2018 - 01.08.2018

9.	Janos Sztrik	Prof. Dr.	Universiteti i Debrecen	Inxhinieri Kompjuterike	Marrëveshje Dypalëshe	04.08.2018 - 11.08.2018
10.	Francesco Defilippis	Dr.	Universiteti Politeknik i Barit	Arkitekturë	ERASMUS+	22.03.2018 - 26.03.2018
11.	Annabruna Menghini	Dr.	Universiteti Politeknik i Barit	Arkitekturë	ERASMUS+	22.03.2018 - 26.03.2018
12.	Foti Dora	Assoc. Prof. Dr.	Universiteti Politeknik i Barit	Inxhinieri Ndërtimi	ERASMUS+	05.02.2018-09.02.2018

Në bazë të marrëveshjeve në fuqi, gjatë vitit 2017-2018 stafin akademik i Universiteti “EPOKA” pati mundësinë të vizitojë një nga institucionet si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër	Titulli Akademik	Universiteti Pritës	Departamenti	Metoda	Periudha e Shkëmbimit
1.	Xhimi Hysa	Assist. Prof. Dr.	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz	Administrim Biznesi	ERASMUS+	16.10.2017-20.10.2017
2.	Huseyin Bilgin	Assoc. Prof. Dr	Universiteti i IASI, “Georghe Asachi”	Inxhinieri Ndërtimi	ERASMUS+	12.11.2017-18.11.2017
3.	Alba Kruja	Dr	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz	Administrim Biznesi	ERASMUS+	06.11.2017-10.11.2017
4.	Julinda Keci	Dr.	Universiteti i Novi Sad	Inxhinieri Ndërtimi	K-FORCE	11.12.2017-15.12.2017
5.	Egin Zeka	MSc.	Universiteti i Teknologjisë i Gdansk	Arkitekturë	ERASMUS+	21.05.2018-25.05.2018
6.	Julinda Keci	Dr.	Universiteti i IASI, “Georghe Asachi”	Inxhinieri Ndërtimi	ERASMUS+	14.05.2018-20.05.2018
7.	Vusal Gambarov	Assist. Prof. Dr.	Universiteti Ndërkombëtar i Logjistikës dhe Transportit në Wroclaw	Administrim Biznesi	ERASMUS+	05.03.2018-09.03.2018
8.	Artan Hysa	MSc.	Universiteti i Teknologjisë i Gdansk	Arkitekturë	ERASMUS+	21.05.2018-25.05.2018
9.	Desantila Hysa	MSc.	Universiteti Politeknik i Barit	Arkitekturë	ERASMUS+	22.04.2018-28.04.2018
10.	Anna Yunitsyna	Dr.	Universiteti Politeknik i Barit	Arkitekturë	ERASMUS+	22.04.2018-28.04.2018
11.	Eglantina Hysa	Assoc. Prof. Dr	Universiteti i Salernos	Ekonomiks	ERASMUS+	16.04.2018-20.04.2018
12.	Alba Gerdeci	MSc.	Universiteti i IASI, “Georghe Asachi”	ZMN/ Staf Administrativ	ERASMUS+	14.05.2018-20.05.2018
13.	Marsela Fejzaj	Ms.	Universiteti Ndërkombëtar i Logjistikës dhe Transportit në Wroclaw	Zyra e Pranimeve/Staf Administrativ	ERASMUS+	30.04.2018-04.05.2018
14.	Enea Mustafaraj	Dr.	DTU, Kopenhagen	Inxhinieri Ndërtimi	K-FORCE	11.03.2018-23.03.2018
15.	Erion Luga	Dr.	UkiM, Shkup	Inxhinieri Ndërtimi	K-FORCE	10.04.2018-22.04.2018

16.	Ali Osman Topal	Dr.	UNIZA, Zilina		K-FORCE	22.04.2018 - 05.05.2018
17.	Artan Hysa	MSc.	Universiteti AAL, Aalborg	Arkitekturë	K-FORCE	06.05.2018-19.05.2018
18.	Artemis Hasa	MSc.	Universiteti LUND	Arkitekturë	K-FORCE	03.06.2018-15.06.2018
19.	Edmond Manahasa	Dr.	Universiteti i Teknologjisë i Gdansk	Arkitekturë	ERASMUS+	18.06.2018-22.06.2018
20.	Sokol Dervishi	Assoc. Prof. Dr.	Universiteti i Teknologjisë i Gdansk	Arkitekturë	ERASMUS+	18.06.2018-22.06.2018
21.	Lorela Kokalari	MSc.	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz	ZMN/ Staf Administrativ	ERASMUS+	16.04.2018-21.04.2018
22.	Alba Gerdeci	MSc.	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz	ZMN/ Staf Administrativ	ERASMUS+	23.04.2016-29.04.2016
23.	Edmond Manahasa	Dr.	Universiteti Politeknik i Barit	Arkitekturë	ERASMUS+	19.02.2018-25.02.2018
24.	Egin Zeka	MSc.	Universiteti Politeknik i Barit	Arkitekturë	ERASMUS+	19.02.2018-25.02.2018

Universiteti “EPOKA” ka pasur gjithashtu bashkëpunim edhe me institucione dhe kompani të tjera joarsimore si më poshtë vijon:

Nr.	Institucioni bashkëpunues	Vendi	Data	Forma	Fushat e bashkëpunimit
1.	Spitali Amerikan	Tiranë, Shqipëri	30.01.2007	Bashkëpunim	Karta Vital për stafin dhe studentët
2.	UNIVERS-ALB	Tiranë, Shqipëri	13.01.2011	Memorandum bashkëpunimi	Ofrimi i Kartave Vital për studentët e Universitetit “EPOKA” nga Spitali Amerikan
3.	Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë	Korçë, Shqipëri	05.02.2011	Memorandum bashkëpunimi	Ofrimi i trajnimeve për stafin e Drejtorisë Arsimore, sigurim i mbarëvajtjes së Provimit të pranimit të Universitetit
4.	CISCO Network Academy	Chennai, Indi	02.03.2011	Projekt	Ofrimi i trajnimeve me çertifikatë
5.	Bank Asya	Stamboll, Turqi	15.04.2011	Memorandum bashkëpunimi	Ofrimi i trajnimeve për stafin e bankës, mundësimi i praktikave të punës për studentët pranë bankës
6.	ProCredit Bank	Tiranë, Shqipëri	01.03.2012	Memorandum bashkëpunimi	Ofrimi i trajnimeve për stafin e bankës, mundësimi i praktikave të punës për studentët pranë bankës
7.	Raiffeisen Bank	Tiranë, Shqipëri	04.03.2012	Memorandum bashkëpunimi	Ofrimi i trajnimeve për stafin e bankës, mundësimi i praktikave të punës për studentët pranë bankës
8.	TEB Bank	Prishtinë, Kosovë	18.05.2013	Memorandum bashkëpunimi	Ofrimi i trajnimeve për stafin e bankës, mundësimi i praktikave të punës për studentët pranë bankës
9.	Këshilli Britanik në Shqipëri (British Council Albania)	Tiranë, Shqipëri	01.11.2013	Bashkëpunim	Përcaktimi i Universitetit “EPOKA” si vend për regjistrimin dhe zhvillimin e provimit ndërkombëtar të gjuhës angleze IELTS
10.	EVEREST IE	Tiranë, Shqipëri	20.11.2013	Marrëveshje Bashkëpunimi	Mundësimi i praktikave mësimore për studentët dhe organizimi i

					aktiviteteve te përbashkëta seminare, simpoziume etj.
11.	Dhoma Shqiptare e Tregtisë Ndërkombëtare dhe Zhvillimit (ACITAD)	Tiranë, Shqipëri	06.12.2013	Marrëveshje Bashkëpunimi	Ofrimi i trajnimeve për stafin e ACITAD, mundësimi i praktikave të punës për studentët pranë ACITAD
12.	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria Arsimit dhe Sportit, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike dhe Konferenca e Rektorëve	Tiranë, Shqipëri	18.12.2013	Marrëveshje Bashkëpunimi	Ofrimi i trajnimeve në Institucionet Publike për studentët e Universiteteve
13.	Konfindustria Shqiptare (KISH)	Tiranë, Shqipëri	20.02.2014	Memorandum bashkëpunimi	Raporte bashkëpunimi për shkëmbimin e informacioneve reciproke dhe organizimit të aktiviteteve të përbashkëta me interes të përbashkët Universitetin dhe KISH
14.	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Tiranë, Shqipëri	04.03.2014	Protokoll Bashkëpunimi	Përfshirja në veprimtaritë e Ministrisë për hartimin dhe përmirësimin e legjislacionit
15.	Këshilli Britanik në Shqipëri (British Council Albania)	Tiranë, Shqipëri	20.06.2014	Marrëveshje	Zbatimi i APTIS Test si provim i njaftueshmërisë së gjuhës angleze për studentët që do të regjistrohen në Universitetin “EPOKA” në vitin 2014-2015
16.	Shkolla e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterit (VISER)	Beograd, Serbi	03.07.2014	Memorandum bashkëpunimi	Shkëmbimin e Studentëve
17.	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë	Tiranë, Shqipëri		Marrëveshje Bashkëpunim	Bashkëorganizim Konferencash dhe Forumesh
18.	Deloitte Albania sh.p.k	Tiranë, Shqipëri	03.12.2014	Marrëveshje Bashkëpunimi	Mundësimi i praktikave mësimore për studentët dhe organizimi i aktiviteteve te përbashkëta seminare, simpoziume etj.
19.	Akademia Diplomatike Shqiptare	Tiranë, Shqipëri	25.01.2015	Memorandum bashkëpunimi	Mundësimi i praktikave mësimore për studentët dhe organizimi i aktiviteteve te përbashkëta seminare, simpoziume etj.
20.	Plus Communication Sh.a	Tiranë, Shqipëri	06.02.2015	Marrëveshje Bashkëpunimi	Mundësimi i praktikave mësimore për studentët dhe organizimi i aktiviteteve te përbashkëta seminare, simpoziume etj.

21.	Albanian Mobile Communication Sh.a (amc)	Tiranë, Shqipëri	05.03.2015	Marrëveshje Bashkëpunimi	Mundësimi i praktikave mësimore për studentët dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta seminare, simpoziume etj.
22.	Communication Progress	Tiranë, Shqipëri	06.03.2015	Marrëveshje Bashkëpunimi	Mundësimi i praktikave mësimore për studentët dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta seminare, simpoziume etj.
23.	Fondacioni Arsimor Shqiptar (FASH)	Tiranë, Shqipëri	25.03.2015	Marrëveshje Bashkëpunimi	Mundësimi i praktikave mësimore për studentët dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta seminare, simpoziume etj.
24.	CHwB Cultural Heritage without Borders	Tiranë, Shqipëri		Bashkëpunim	Aktivitete të ndryshme në fushën e Restaurimit dhe Ndërtimit në Shqipëri dhe më tej
25.	Dipartimento ICAR Politecnico di Bari & AKPT Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit	Tiranë, Shqipëri Bari, Itali	14.04.2015	Memorandum bashkëpunimi	Forma të ndryshme bashkëpunimi në aktivitetet mbi planifikimin urban të territorit
26.	Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile	Tiranë, Shqipëri	21.04.2015	Memorandum Bashkëpunimi	Bashkëpunimi dypalësh nëpërmjet mbështetjes së veprimtarive kërkimore dhe aplikative, përgatitjes së projekteve të përbashkëta si dhe veprimtarive profesionale dhe trajnuese ndërmjet stafit të të dy institucioneve.
27.	DM Consulting Services	Tiranë, Shqipëri	30.06.2015	Marrëveshje Bashkëpunimi	Mundësimi i praktikave mësimore për studentët dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta seminare, simpoziume etj.

Në bazë të marrëveshjeve, gjatë vitit akademik 2017-2018 studentët e Universitetit “EPOKA” patën mundësinë të kryejnë praktikën profesionale në institucionet si më poshtë vijon:

Duke bashkëpunuar me institucione publike dhe private të cilat operojnë në tregun vendas, Universiteti “EPOKA” u vjen në ndihmë studentëve të tij të kryejnë praktikat profesionale. Në këtë mënyrë studentët nuk do të pajisen vetëm me njohuri teorike por do të njihen edhe me kompani prestigjioze në vend. Ky program në Universitetin “EPOKA” është një përpjekje serioze për ti drejtuar studentët drejt tregut të punës, gjë e cila do ti ndihmojë studentët në momentin e diplomimit në përshtatjen me tregun. Praktikrat profesionale janë një mundësi shumë e mirë për të përsosur shumë nga perceptimet fillestare të studentëve lidhur me realitetin konkret.

Studentët nëpërmjet faqes në web <http://cpao.epoka.edu.al/internship/web/> kanë të drejtë të përzgjedhin tre kompani në bazë të prioritetit, ku më pas do të përzgjidhen vetëm nga një kompani apo institucion për të kryer praktikën profesionale.

Në vitin akademik 2017-2018 kanë përfutur praktikë profesionale nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar 145 studentë. Më poshtë do të gjeni tabelën me kompanitë dhe institucionet të cilat kanë ofruar programin e praktikës studentëve të Universitetit “EPOKA”.

Nr.	Institucioni/ Kompania	Nr. i Studentëve
1	Abissnet	1
2	Abkons	1
3	Agna group	3
4	Albafilm	1
5	Kuvendi i Republikës së Shqipërisë	6
6	AMD Shpk	4
7	Atlantic Council o Albania	1
8	Balfin Group	10
9	Boiken Developments	2
10	Banka Credins	3
11	Crimson Finance Fund Albania	1
12	Deloitte Albania & Kosova	9
13	Ernst & Young	4
14	Digicom	1
15	British American Tobacco	1
16	Gener 2	4
17	Drejtoria e Përgjithshme e Taksave	1
18	Holta shpk	1
19	Infosoft Group	2
20	Intesa Sanpaolo Bank	6
21	Epoka ICTC	2
22	Ernst & Young	1
23	Eurosig	1
24	Ikub Info	1
25	Intesa Sanpaolo Bank	6
26	Jon Construction	1
27	Kontakt shpk	4
28	Local web	1
29	Mane TCI	3
30	Marketing & Distribution	1
31	Mazars	1
32	Megatek	3
33	Ministria e Financave	1
34	NBG	5
35	NOA	2
36	Orion Construction	1
37	Pianetra Shpk	1
38	Pragmatic Software Shpk	1
39	Procredit Bank	4
40	Telekom Albania	8
41	Pwc Albania	1
42	Raiffeisen Bank	9
43	Vodafone Albania	17
44	Societe Generale Albania	1
45	Softics Lab	3
46	Spitali Amerikan	1

47	Tirana Business park	1
48	Union Bank	1
49	Unioni Financiar	1

Universiteti “EPOKA” merr pjesë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, mundëson fonde për kërkime shkencore për të gjithë kërkuesit/stafin akademik dhe studentët e doktoraturës në Universitet.

Projektet ku Universiteti “EPOKA” është angazhuar janë të paraqitura më poshtë.

Projekte Ndërkombëtare

Universiteti EPOKA është partner i plotë në Projektin Erasmus+, "*Mbështetje Strategjike në forcimin e strukturave për sigurimin e cilësisë në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri*", me numër projekti **561510-PPE-1-2015-1-AT-EPPKA2-CBHE-JP (QAinAL)**, I aprovuar në nën thirrjen KA2 - aftësia për inovacione dhe shkëmbimin e praktikave të mira - Ngritja e Kapaciteteve në fushën e Arsimit të Lartë (Thirrja për propozim projekte EAC/A04/ 2014), financuar nga Komisioni Evropian. Ky projekt ka filluar në tetor të vitit 2015 dhe do të përfundoj në nëntor të vitit 2018. Qëllimi më i gjerë i projektit është të krijojë dhe mbështesë proceset dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë për të siguruar menaxhim efektiv dhe për të përmirësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri. Projekti synon të mbështesë institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri për të arritur prioritetet e dy dokumenteve kryesore: "Rritja e ndikimit të Zhvillimit të BE-së: Agjendë për Ndryshim" dhe "Arsimi i Lartë Evropjan në Botë".

Projekti i dytë që Universiteti EPOKA është angazhuar përmes thirrjes së Erasmus+ (EAC /A04/2014), është projekti me numër **561485 - EPP-1-2015-AT-EPPKA2 -CBHE-JP me emrin " Zhvillimi i Planprogrameve Mësimore të përbashkëta evropiane në Shkencat Politike- MA "**, dhe në këtë projekt Erasmus + të udhëhequr nga Universiteti i Salzburgut, Universiteti EPOKA është partner strategjik dhe ka të drejtë të marr pjesë në të gjitha aktivitetet që lidhen me të, por nuk është pjesë e konsorciumit në Masterin e përbashkët. **Projekti ka filluar në tetor 2015 mbaron në tetor të vitit 2018.**

